

**AKT THEMELUES**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"ARAMERAS SHPK"**

**Ndermjet :**

Shoqerise te te drejtes Italiane TORCELLO HOLDING S.A. me seli ne L -1724 Luksemburg,19-21,bd Princ Henri, e perfaqesuar nga perfaqesuesi i saj ligjor z.Bruno TOGNETTO,lindur ne Campiglia dei Berici (VI), me18.05.1946,dhe banues ne Via "Ugo Foscolo",4E,Campiglia dei Berici,Itali.

dhe

z.Bruno TOGNETTO ,lindur ne Campiglia dei Berici(VI),me 18.05.1946,dhe banues ne Via "Ugo Foscolo",4E,Campiglia dei Berici,Itali.

Ne baze te Ligjit nr.7512 dt. 10.8.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private te nismes se lire,te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit" dhe ne zbatim te Ligjit nr. 7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe te Ligjit nr. 7667 dt. 28.1.1993 "Per regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare ",palet me kete Akt Themelues, bien dakord dhe vendosin sa me poshte :

**N e n i 1**

**EMERTIMI**

1.1. Te krijojne Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "ARAMERAS shpk "

**Neni 2**

**SELIA**

2.1. Shoqeria e ka seline ne Republiken e Shqiperise,Rruga "Arkitekt Kasemi",Pallati 71,apartamenti 28,Tirane dhe mundet te ngreje seli sekondare ne territorin e Shqiperise dhe jashte.

**N e n i 3.**

**KARAKTERISTIKAT**

3.1.Kjo Shoqeri eshte person juridik i te drejtes Shqiptare ; aktiviteti i saj do te kryhet ne perputhje me kete Akt Themelues,me Statutin bashkelidhur dhe



detyrimet kontraktore te ortakeve themelues. Ortaket nuk do te pergjigjen per detyrimet qe i takojne Shoqerise te cilat kalojne kufijte e kontributit qe ata kane shlyer ne kapitalin e saj.

**N e n i 4.**

#### **OBJEKTI**

Shoqeria e krijuar ka per Objekt :

-ndertimin e objekteve, rikonstruksione dhe mirembajtje, si dhe blerje, shitje, kembime, qira, sistemim dhe administrim te pasurive te palujtshme, edhe si komplekse ndermarjesh, industriale dhe tregtare duke perfshire dhe studio, projektimi dhe konsulence teknike qe kane lidhje me to;

-tregtimi i materialeve te ndertimit.

-ekzekutimi i punimeve te blerjes se tereneve dhe ndertimit ne to, urbanistikes.

Shoqeria mund gjithashtu te plotesoje te gjitha operacionet me pasurite e lujtshme te palujtshme, tregtare dhe financiare qe cilesohen si te pershtateshme per vazhdimin e qellimit social.

**N e n i 5.**

#### **KOHEZGJATJA**

5.1. Kohezgjatja e Shoqerise caktohet deri ne 31.12.2020 dhe mund te zgjatet me tej me vendim te Asamblese se ortakeve.

Shoqeria mund te shkrihet edhe para kohe nese verifikohet cilido nga shkaqet e parashikuara ne Nenin 72 te ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

**N e n i 6**

#### **KAPITALI**

6.1. Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 100 000 leke (njqindmije) dhe ndahet ne 100 pjese te barabarta me nga 1000 leke sejcila; sejcili ortak mer pjese ne kete kapital si me poshte :

1. TORCELLO HOLDING S.A. 99 pjese.


2. Bruno TOGNETTO 1 pjese.

Pra gjithsej 100 pjese qe jane baraz me 100 % te kapitalit themeltar.

**N e n i 7.**

#### **SHLYERJA E KAPITALIT**

7.1. Ne zbatim te nenit 40 te Ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992, vlefte e Kapitalit Themeltar u shlye krejtesisht nga themeluesit me daten 8 Qershor 1995 ne Banken Italo Shqiptare, Rruga e Barikadave Tirane, ne llogarine e hapur me nr. 401406, sipas fatures qe i bashkelidhet ketij Akti Themelues (Lidhja 1).



## N e n i 8

### ADMINISTRIMI

8.1. Shoqeria administrohet nga nje ose me shume administratore. Nga data e krijimit Shoqeria do te administrohet nga z. Bruno TOGNETTO ,lindur ne Campiglia dei Berici, me 18.05.1946, Itali.

Administartoret e lartpermendur qendrojne ne kete detyre per tre vjetet e ardhshem dmth deri ne 8 Qershor 1998, me te drejatat e administrimit e te perfaqesimit te treguara ne nenin 17 te Statutit bashkelidhur (lidhja 3).

## N e n i 9.

### FITIMI

9.1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria mbas zbritjes se taksave, shpenzimeve dhe rezerves se domosdoshme, do te ndahet ndermjet ortakeve proporcionalisht me perqindjen e pjesmarjes te sejcilit ne Kapitalin Themeltar

9.2. Fitimi i ortakut te huaj mund te transferohet jashte Shqiperise sipas Nenit 17 te Ligjit nr. 7512 dt. 10.8.1991 dhe kushteve te vena ne dispozitat Ligjore Shqiptare.

## N e n i 10.

### EKSPERTET KONTABEL.

10.1. Shoqeria mund te kete nje ose me shume eksperte kontabel sic parashikohet ne nenin 65 dhe 69 te ligjit nr 7638 dt 30.11.1992.

## N e n i 11.

### AKTIVITETI FINANCIAR

11.1. Aktiviteti financiar mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti. I pari do mbyllet ne 31 Dhjetor te ketij viti. Bilanci dhe anekset perkatese do te kryhen sipas Ligjit nr. 7661 dt. 19.1.1993 "Per kontabilitetin".

## N e n i 12.

### STATUTI

12.1. Shoqeria disiplinohet sipas dispozitave te Statutit bashkelidhur (lidhja 3), qe konsiderohet pjese perberese dhe esenciale e kesaj kontrate.

## N e n i 13

### LIKUIDIMI.

13.1. Shoqeria shkrihet me mbarimin e afatit te percaktuar ose me perpara me vullnetin e ortakeve te mbledhur ne asamblene e jashtzakoneshme sipas percaktimit dhe parashikimit ne legjislacionin Shqiptar.

Qe nga data qe deklarohet shkrija e saj Shoqeria vendoset ne likuidim e siper.



Ortakët sipas shumicës të përcaktuar në Statutin që i është bashkëlidhur këtij Akti Themelues dhe Legjislacionit Shqiptar, emerojnë një ose më tepër likuidatorë dhe në rast se ata nuk kanë mundur, emërimi i likuidatorit do të bëhet nga Gjykata e Tiranës, me kërkesën e çdo personi të interesuar.

**N e n i 14.**

**GJYKATA KOPETENTE.**

14.1 Çdo mosmarrëveshje që ka për objekt efektivitetin, zbatimin, interpretimin, ose zgjidhjen e këtij Akti Themelues dhe Statutit ose që lidhet me marrëdhëniet midis ortakëve të vecantë ose midis tyre dhe Shoqërisë, nëse nuk zgjidhen në mirëkuptim, është në kompetencë ekskluzive të Gjykatës së Tiranës.

**N e n i 15.**

**SHPENZIMET.**

15.1. Të gjitha shpenzimet që rrjedhin nga ky Akti Themelues si dhe ato që janë të lidhura me të do të ngarkohen Shoqërisë.

**PER TORCELLO HOLDING S.A.**

BRUNO TOGNETTO

**z. Bruno TOGNETTO**



**Date, 8 Qershor 1995.**

STATUTI  
|  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

**KAPITULLI 1**

**EMERTIMI,SELIA,OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE.**

**N e n i 1.**Eshte krijuar Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ARAMERAS shpk".

Shoqeria "ARAMERAS shpk " eshte Shoqeri e te drejtes Shqiptare.

Emertimi i shoqerise "ARAMERAS sh.p.k.", numri i regjistrimit dhe adresa e saj duhet te shenohen ne te gjithë korespondencen e saj,ne fatura,ne reklamat,etj.

**N e n i 2.**Shoqeria ka seline ne Republiken e Shqiperise;Rruga "Arkitekt Kasemi",Pallati 71,ap 28,Tirane.

Shoqeria mund te kriroje zyra perfaqesimi,agjensi,dege ne vende te tjera .

**N e n i 3.**Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne perputhje me kete Statut, Aktin Themelues dhe Legjislacionin Shqiptar.

**N e n i 4.**Shoqeria ka per Objekt te veprimtarise se saj :-punime ndertimi,rikonstruksioni,mirembajtje,sidhe blerje,shitje,kembimin,dhenie dhe marrje me qira,sistemim dhe administrime te pasurive te palujtshme,edhe si kompleks ndermarjesh,industriale e tregtare si dhe studiosh,projektimi dhe konsulence teknike qe kane lidhje me te.

-tregetimi i materialeve te ndertimit.

-ekzekutimi i punimeve te- blerjes se terreneve per ndertimin ne to, -urbanistikes.

Shoqeria mund gjithashtu te plotesoje te gjitha operacionet te pasurive te lujtshme dhe te palutshme,tregtare dhe financiare qe cilesohen si te pershtateshme per vazhdimesine e qellimit social.

Shoqeria mund te perdore Kapitalin Themeltar dhe pasurite esaj sipas deshires por gjithmone per qellimin e permbushjes te objektit te saj te veprimtarise.



**N e n i 5** Kohezgjatja e Shoqerise eshte e percaktuar deri ne 31 Dhjetor 2020.

## **Kapitulli II**

### **KAPITALI THEMELTAR**

**N e n i 6.**Kapitali Themelor eshte 100 000(njeqindmije) leke dhe ndahet ne pjese sipas nenit 38 te Ligjit nr. 7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".Cdo pjese ne Kapitalin Themeltar perfaqeson nje vote.

**N e n i 7.**Pjeset jane te transferueshme me marreveshje per te gjallet dhe me rruge trashegimnie ne rast vdekje.

Pjeset nuk mund te dhurohen.

Ne rast transferimi te te gjitha ose te nje pjese pjesesh me marreveshje per te gjallet, ortakeve te tjere u takon e drejta dhe mundesia per te blere kuoten e mesiperme,proporcionalisht me kapitalin qe posedojne.

Per kete qellim ortaku qe transferon teresisht ose pjeserisht pjeset e tij,duhet te njoftoje Administratoret e Shoqerise me leter rekomande per emrin e bleresit,cmimin dhe kushtet e tjera te transferimit.

Administratori duhet t'u njoftoje propozimin e transferuesit ortakeve te tjere brenda 15 ditesh nga marrja e njoftimit me anen e nje letre rekomande.

Ortaket qe perfaqesojne nje pjese jo me pak se tre te katertat e Kapitalit Themeltar,ne tre muajt ne vazhdim mund te aprovojne ose jo transferimin e mesiperm duke e komunikuar me leter rekomande.

Ne rast te pergjigjes negative ,ortaket e tjere brenda tre muajve ne vazhdim mund te blejne ose t'u lejojne te treteve blerjen te te gjitha pjeseve qe jane objekt i propozimit te transferimit me cmimin,afatin dhe sipas menyres te percaktuar ne nenin 11 te Ligjit nr.7638 dt.19.11.1992.

Kjo e drejte dhe mundesia e blerjes ju jepet ortakeve te tjere vetem nese kryhet per te gjitha pjesen e ofruar per shitje.

Ne kete rast sejcili ortak ne njoftimin per blerjen e pjeses qe mendon,ne proporcion me ate qe posedon,duhet te shenoje ne pergjigjenj e tij ndaj administratorit,ne se eventualisht ka per qellim qe te bleje pjeset e mundeshme te mbetura.

*a/u*

*a/u*

Ne rast te mos blerjes se pjeseve nga ana e ortakeve,ato mund t'u transferohen te treteve me te njejtat kushte dhe modalitate.Ne rast te trashegimise per shkak vdekjeje,trashegimtareve do t'u likuidohen

pjeset e Kapitalit Themeltar mbi bazen e gjendjes pasurore ne momentin e vdekjes.

### Kapitulli III

#### ASAMBLEA E ORTAKEVE.

**N e n i 8** Asamblea thirret nga njeri prej Administratoreve ne seline e Shoqerise ose ne nje vend tjeter,me anen e njoftimit ne te cilin shenohet dita,ora,dhe vendi i mbledhjes dhe ceshtjet qe do te trajtohen,i cili u dergohet ortakeve prane vendbanimit te tyre me leter rekomande jo me vone se 15 dite para dates se fiksuar per mbledhje.

Vendbanimi i ortakeve per efekt te thirjes se antareve te Asamblese dhe per cdo maredhenie tjeter me Shoqerine,eshte ai i shenuar ne Aktin Themelues ose ai i deklaruar ne momentin e blerjes se pjeses.Ndryshimet eventuale te vendit te banimit duhet t'i komunikohen Shoqerise me leter rekomande.

Ne rast te mos respektimit te formalitetit te mesiper,Asamblea konsiderohet e mbledhur ne menyre te rregullt kur perfaqesohet i gjithe Kapitali Themeltar dhe jane te pranishem te gjithe Administratoret dhe ekspertet kontabel .

**N e n i 9.**Asamblea e ortakeve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur marrin pjese ortaket qe perfaqesojne shumicen e Kapitalit Themeltar dhe vendos me voten "pro" te shumices se Kapitalit Themeltar.

Ne thirrjet pasuese te Asamblese pavaresisht nga pjeset e kapitalit Themeltar qe perfaqesohen nga ortaket pjesmarres,vendoset me shumicen e te pranishmeve.

Per marrjen e vendimeve qe lidhen me modifikime te Statutit,transferimin e Shoqerise prishjen e parakoheshme te saj sic parashikohet ne nenet 59,60 te Ligjit nr.7638 te dt.19.11.1992,Asamblea e ortakeve do te vendosi me voten "pro" te shumices se ortakeve qe perfaqesojne tre te katertat e Kapitalit Themeltar.

**N e n i 10.** Asamblea e ortakeve duhet te thirret te pakten nje here ne vit ,brenda kater muajve nga mbyllja e vitit fiskal.Per raste te vecanta,sipas gjykimit te administratoreve afati i thirrjes mund te zgjatet deri ne fund te 6 muajve nga data e mbarimit te vitit fiskal.

du

du

**N e n i 11.** Asamblea drejtohet nganjëri prej Administratoreve dhe në mungesë të tij nga një person i caktuar nga Asambleja.

**N e n i 12.** Ortaku ka të drejtë të përfaqësohet në asamble edhe me anën e një personi tjetër jo ortak të deleguar me një dokument të shkruar.

**N e n i 13.** Asambleja e mbledhur rregullisht përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e saj të marra në konformitet me ligjin dhe Statutin detyrojnë të gjithë ortakët jo pjesëmarrës.

#### **Kapitulli IV**

#### **ADMINISTRIMI**

**N e n i 14.** Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratore të zgjedhur nga Asambleja e zakonshme. Mund të caktohen si administratore edhe persona që nuk janë ortakë .

Administratorët qëndrojnë për tre vjet dhe janë të rizgjedhshëm.

Në rast të emerimit të një administratori të vetëm ,të gjitha kompetencat dhe detyrimet e administruesit i referohen Administratorit të vetëm.

Në aktin e emerimit të administratoreve duhet të përcaktohen edhe kufijtë e kompetencave që u jepen atyre.

**N e n i 15.** Cdonjeri nga administratorët,saherë që e shoh të nevojshme thërrët mbledhjen e administratoreve duke përcaktuar vendin, ditën dhe orën e mbledhjes .

Thirrja për mbledhje bëhet me leter rekomandë të njoftuar jo më pak se 8 ditë përpara mbledhjes.

Në rast urgjence mbledhja mund të njoftohet edhe me telefax të dërguar dy ditë përpara mbledhjes.

Mbledhja e administratoreve dhe vendimet e saj janë të vlefshme edhe pa thirrjen,kur të gjithë administratorët dhe ekspertët kontabel janë të pranishëm.

**N e n i 16.** Administratorët mund të vendosin vetëm në qoftë se janë prezent shumica e administratoreve dhe vendimet merren nga shumica e votave të administratoreve prezent.

#### **N e n i 17**

Administratorët mund të bëjnë gjithçka për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë me përjashtim të kompetencave që sipas Ligjit ose Statutit i takojnë ekskluzivisht Asamblese se ortakëve.





Ne rast te nje administratori te vetem,ai gezon te gjitha kopetencat qe do te kishin ne rast se Administratoret do te ishin me shume se nje.

**N e n i 18.** Administratori ose administratoret jane perfaqesues te ligjshem te ligjshem te Shoqerise si ndaj te treteve edhe para Gjykates.

Administratori mund te emeruje perfaqesues per akte speciale ose disa te tille.

#### **Kapitulli V**

#### **EKSPERTET KONTABEL**

**N e n i 19.** Aktiviteti i Shoqerise kontrollohet nga nje ose disa eksperte kontabel kur kerkohet nga neni 65 i Ligjit nr.7638 dt.19.11.1992 ose kur vendos Asamblea e ortakeve.

Ne aktin e emerimit te tyre Asamblea percakton edhe masen e shperblimit te tyre.Ekspertet zgjidhen per nje periudhe 6 vjecare dhe jane te rizgjedhshem.

#### **Kapitulli VI**

#### **BILANCI DHE DESTINACIONI I TE ARDHURAVE**

**N e n i 20.** Aktiviteti i Shoqerise mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne fund te cdo viti Administratori ben bilancin duke paraqitur gjendjen ekonomike,llogarine e fitimit e te humbjeve ne nje relacion te administrimit te Shoqerise ne perputhje me Ligjet.Asamblea vendos per destinacionin e te ardhurave.Shoqeria mund te llogarise rezerven e domosdoshme qe eshte pjese e te ardhurave te cilitdo aktivitet ose te krijoje fonde te reja.

Natyra e fondeve dhe perdorimi i tyre do te percaktohet nga administratoret sipas ligjeve te Shqiperise.

#### **Kapitulli VII**

#### **LIKUIDIMI I SHOQERISE**

**N e n i 21.** Shoqeria shkrihet pervecse ne rastet e parashikuara nga ligjet shqiptare edhe ne keto raste :

- a)Mbarimi ne afatin e parashikuar ne Aktin Themelues.
- b) Pamundesia e realizimit te objektit te Shoqerise.
- c)Me vullnetin e ortakeve

Likuidatoret do te caktohen ne baze te Ligjit nr. 7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"

#### **Kapitulli VIII**

#### **KOMPETENCAT**

*o/w*

*o/w*

Neni 22.Vendimi per gjithë mosmarreveshjet qe mund te lindin midis ortakeve ose midis ortakeve dhe Shoqerise i kalon me kopetence ekskluzive Gjykates se Tiranes.

## Kapitulli IX


### DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 23.Persa nuk parashikohet shprehimisht ne kete Statut do tu referohet dispozitave ne ligjin nr. 7638, dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

PER "TORCELLO HOLDING S. A."

Bruno TOGNETTO

BRUNO TOGNETTO



Date.8 Qershor 1995.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR 4968 REP  
NR 643 KOL

### V E R T E T I M

Not me daten 9.6.1995, ditën e Premte, perpara meje Noteres Publike u paraqiten personalisht ; Shoqeria Aksionere "TORCELLO HOLDING" S.A., perfaqesuar nga Bruno Tognetto, sipas vendimit Gjykates se Luksemburgut 42920 dt 15.2.1993 sipas proces verbalit te Keshillit Administrativ Per Shoqerite Anonime dt 23 Maj 1995, me seli ne ne L. 1724 Luksemburg 19-21,bd. Prince Henri dhe Bruno Tognetto, i biri i Egidio dhe i Markezen, lindur ne Campiglia Dei Berici me 1946 me pasaporte 167881 A, madhore me zotesi te plote juridike, qe me vullnet te lire e te plote u neneshkruan Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqerise "ARMERAS" shpk dhe une e vertetoj rregullisht sipas ligjit .



NOTERE PUBLIKE  
SHPRESA KURTI

